

VENDIM
Nr.2, datë 6.1.2011

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË VITIT 2011, PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të vitit 2011, për menaxhimin e shpenzimeve publike, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria Financave, Ministria e Integritetit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, si dhe fondet speciale të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KALENDARI I MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE 2011

Periudha	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi përkatës
Dhjetor 2010	28	MF	Përgatit dhe paraqet në KPS kalendarin e MSHP
Dhjetor 2010	30	KPS/KM	Shqyrton dhe miraton kalendarin e MSHP-së
Janar	6	MF	Paraqet në KPS raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore
Janar	12	KPS/KM	Miraton raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore (RVPMB) KM miraton RVPMB
Janar	19	KM	Shqyrton dhe miraton programin EFP
Shkurt	4	DEBASKON	Paraqet në KPS për diskutim dhe miraton politikatat prioritare me ndikim në tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	10	MF	Paraqet në KPS tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	17	KPS/KM	KPS shqyrton tavanet e përgatitjes së PBA-së dhe i dërgon për miratim në KM. Tavanet e përgatitjes së PBA-së miratohen në KM
Shkurt	24	KM	Paraqet për informacion RVPMB dhe tavanet në Kuvend
Shkurt	25	MF	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale

Shkurt-prill	28 shkurt-29 prill	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Përgatitin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	29	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2-17	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave buxhetore
Maj	18-31	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Qershor	3	MF	Dorëzon për miratim në KPS parashikimin e përditësuar makro
Qershor	10	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Qershor	1-13	MF	Përgatit dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së
Qershor	17	MF	Paraqet dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së për shqyrtim dhe miratim në KPS
Qershor	30	KPS/KM	Miraton dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së
Korrik	26	MF	I paraqet Kuvendit për informacion vendimin e miratuar të dokumentit të rishikuar të PBA-së
Korrik	8	MF	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale
Korrik-gusht	11 korrik-30 gusht	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Përgatitin kërkesat e rishikuara buxhetore
Gusht	31	Njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1-16	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	19-30	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Tetor	5	MF	Paraqet në KM parashikimin e përditësuar makro
Tetor	14	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro

Tetor	20	MF	Përgatit dokumentin e rishikuar të PBA-së, projektbuxhetin vjetor dhe i paraqet për shqyrtim në KPS
Tetor	25	KPS/KM	Miraton projektbuxhetin vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së
Tetor	31	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së